

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË
Dt.26.06.2025

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rehabilitimi i digës Pepel 1”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):90722000-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 77.719.265 (Shtatëdhjetë e shtatë milion e shtatëqind e nëndëmbëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e pesë)lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Dropull** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, dhe 2024** lëshuar nga administrata tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, "Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.", si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik": Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar". Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur/ fondit limit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në

miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

- 2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023,** dhe **2024**, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore), dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të *ligjit Nr.10 091, datë 05.03.2009*, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke pasur parasysh që lloji i procedurës është “e hapur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “b” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është në nenin 43, pika 1” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/entikontaktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

- 2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë shlyer taksat për vitin **2023** dhe **2024** për adresën ku ai ushtron aktivitet sipas Ekstraktit Historik lëshuar nga QKR, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku nëse kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë vërtetim/e lëshuar nga Bashkia me anë të së cilit të vërtetohet shlyerja e këtyre taksave sipas vetëdeklarimit të kryer në shtojcën 8 të DST-së.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50 %** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
ose
- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Aktin e Kolaudimit të objektit*
- iv. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9*
- v. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.*

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit*
- iii. Faturat Tatimore sipas legjislacionit tatimor*
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit*

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e

pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura të ben oferten të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.” AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku qartazi përcaktohet se: ***“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.***

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti

*kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.***

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private lëshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuader të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit lëshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku ndër të tjera përcaktohet se: **“Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

▪ **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **NP-1 B** Punime Germimi ne toke
- **NP-2A** Ndertime civile dhe industriale
- **NP-4 A** Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale
- **NP-5 B** Punime nëntokësore, ura e vepra arti
- **NP- 6 C** Diga dhe tunele hidroteknike
- **NP-7 B** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje
- **NP- 9B** Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- **NP- 12A** Punime të inxhinierisë mjedisore

▪ **Për punimet speciale të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **NS -6A** Sinjalistika rrugore jodriçuese
- **NS -7A** Barriera dhe mbrojtje rrugore
- **NS-8A** Ndërtime parafabrikat beton arme.
- **NS-9A** Punime strukturore speciale.
- **NS-10A** Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- **NS-18C** – Punime topogjeodezike –
- **NS-20A** – Shpime gjeologo-inxhinierike puse e shpime per uje.

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Licensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Licensa Profesionale.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu Te dhënat për liçencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 përcakton "Zbatimi I punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, private ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me liçencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjërmimi në tokë.	Punime gjërmim dheu, Punime prishje, Punime gjërmim shkëmbi i fortesive të ndryshme me ekskavator	B	21-50 milion
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	Punime betoni dhe betonarme.	A	0-20 milion
NP-4	Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale	Shtresa rrugore dhe punime të tipologjise se rrugeve dytesore dhe/ose linja të punimeve	A	0-20 milion
NP-5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi "goma" ose mbi "hekur", kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse,	B	21-50 milion

		plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.		
NP-6	Diga dhe tunele hidroteknike	Punime për mbrojtjen e diges.	C	51-100 milion
N.P - 7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.	B	21-50 milion
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Punimet e rehabilitim të kanalit vadites të diges (bjefi i poshtem)	C	51-100 milion
NP-12	Punime të inxhinierisë mjedisore	Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.	A	0-20 milion
N.S – 6-	Sinjalistika rrugore jodriçuese	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.	A	0-20 milion
N.S - 7	-Barriera dhe mbrojtje rrugore	Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi i elementeve si guard rail, New Jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.	A	0-20 milion
NS-8	Ndërtime parafabrikat beton arme.	Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.	A	0-20 milion
NS-9	Punime strukturore speciale	Veshja e diges me beton.	A	0-20 milion

NS-10	Shtresa dhe mbistruktura speciale	Veshja e diges me beton.	A	0-20 milion
NS-18	Punime topogjeodezike	Punime topogjeodezike	C	51-100 milion
NS-20	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.	Shpime gjeologjike te cilat do te nevojiten per kontrollimin e filtrimeve ne trupin e diges.	A	0-20 milion

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatat ISO, si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN **ISO 9001-2015** e përfitësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN **ISO 14001-2015** e përfitësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH **ISO 45001:2018** e përfitësuar, (**SSH EN ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shendetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH EN **ISO 50001-2018**, e përfitësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- a) Certifikatën SSH EN **ISO 3834-2:2021**, e përfitësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë në Saldim e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do te paraqese ISO-t në baze te zerave te punimeve qe ka marre persiper te realizoje.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 12 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

1. **ISO 9001:2015** është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.
2. **ISO 14001:2015** ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.
3. **ISO 45001-2018** është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.
4. **ISO 3834-2:2021** standart ky që përcakton rëndësi dhe fushëveprim të produkteve kritike të sigurisë, kompleksiteti i prodhimit, koha e përdorimit të prodhimeve të prodhuara, sfera e problemeve metalurgjike që mund të ndodhin, defektet, deformimet ose defektet e saldimit që ndikojnë në performancën e produktit në kuptimin e fushës së kualitetit të detajuar, standart dhe themelor të cilësisë ISO 3834-2.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **100 (njëqind) punonjës** me kohë të plotë pune, për periudhën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe Stafi menaxherial i Drejtuesve Teknik. Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **100 (njëqind)** punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, me kohë të plotë pune, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, , ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e punimeve. Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “*Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*”. Përlllogaritja e numrit total të punonjësve është bërë në bazë të manualit teknik

nr.		punimeve		si		më		poshtë:		–			
NR.	KODI	EMËRTIMI PUNIMEVE.		NJËSIA									
11		PUNIME PER REHABILITIMIN E DIGES											
		I 1 Punime Skarifikimi				Ore pune/njesi	Makine ri/njesi	Sasia	Ore pune, pune to ria	Dite sipas grafikut	Dite Pune	Nr Puntore sh	Ore pune, makine ri dhe pajisje
1	3.2	Preje bime te vogla ø-10cm		m2		0.08	0.00	500.0	40.00	30.00	5.00	100	0.00
2	3.3	Preje e sistemit pemesh ø 10 - 20 cm		cope		0.40	0.00	47.0	38.80		2.35	100	0.00
3	3.7	Shkulje e rrenjete te bimeve te vogla		cope		0.20	0.00	120.0	24.00		3.00	100	0.00
		SHUMA 1:		Lek									
12		Punime Dheu											
1	3.106/a	Gërmim dheu me ekskavator zingjër 0.5 m³,prani ujë ~2m kategoria IV, me shk në mjet		m3		0.00	0.07	3800.0	0.00	60.00	0.00	0.00	269.80
2	3.112/b	Pastrim rezervuari heqje aluvionesh nga (bjefti sipem, shka kuesik/fik pjesa fundore e diges) filtrime shk në mjet		m3		0.00	0.05	1458.0	0.00		0.00	0.00	71.44
3	An-1	Mbushje me argjile ,hedhje ,na fshim e ngjeshje dheu ne trup dige me cilindër me dhembe		m3		0.03	0.19	5088.0	152.64		6.36	3.00	966.72
4	3.158/4a	Transport dheu me auto deri 4.0 km		m3		0.00	0.00	5088.0	0.00		0.00		0.00
5	An-2	Prishje e veshjes me gure (kalidre m) ekzistues		m2		0.70	0.13	2750.0	1925.00		48.13	5.00	343.75
		SHUMA 2:		Lek									
13		Punime Betoni dhe Betonarmeje											
1	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20 (pjesa fundore e bjeftit sipem)		m3		12.80	2.29	2199.0	28147.20	150.00	70.37	50.00	5035.71
2	3.208	Shtrese Çakelli t=15cm, makadam, perhapur e ngjeshur me makineri(pjesa fundore e bjeftit sipem)		m2		0.05	0.08	21986.0	1055.33		18.85	7.00	1714.91
3	2.262/5	Veshje kanalime beton t=20cm, C20/25		m3		8.60	0.73	12.0	103.20		1.29	10.00	8.76
4	3.64	Veshje skarpatesh 10 cm zhavor + 20 cm gure		m2		1.91	0.00	855.0	1633.05		20.41	10.00	0.00
5	3.409	Isolimi i uja ve ne fuga pas betonimit (bjefti l sipem)		ml		1.00	0.00	2800.0	2800.00		35.00	10.00	0.00
6	3.643	Mbjeftje bari ne skarpat (bjefti l poshtem)		m2		0.17	0.00	1500.0	255.00		3.19	10.00	0.00
7	An-3	F.V Zgare metalike e elektrosakuar Ø 6mm/15cm ne te dy drejtimet (Plegma)		m2		0.00	0.50	21986.0	0.00		0.00	1.00	10993.00
8	2.166/1a	F.V hekur betoni peridok Ø > 12 mm (vepra e marjes+shka kuesi)		ton		42.00	0.63	0.2	8.40		0.11	10.00	0.13
		SHUMA 3:		Lek									
14		Punime vepra arti te vogla rruga											
1	3.124/2a	Gërmim shkemb i forte, sek i detyruar, me ekskavator		m3		0.00	0.78	85.0	0.00	60.00	0.00	0.00	66.30
2	3.366	Tombino me tuba betoni Ø 800, mbi shtrese betoni		ml		5.60	0.25	12.0	67.20		4.20	2.00	3.00
3	2.133/1	Detaje teknike prej betoni C16/20 (brije + dalje)		m3		30.17	4.70	12.0	362.04		9.05	5.00	56.40
		SHUMA 4:		Lek									
15		Punime te shkarkuesi katastrofik											
1	3.87/a	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m³,ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne toke		m3		0.00	0.09	765.0	0.00	60.00	0.00	0.00	71.91
2	3.25/a	Gërmim me krahe seksion detyruar me gjeresib < 1 m, h=1.5 m, materiale mbushese		m3		4.90	0.00	172.0	842.80		10.54	10.00	0.00
3	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20		m3		12.80	2.29	55.0	704.00		44.00	2.00	125.95
4	An-4	F.V Zgare metalike e elektrosakuar Ø8mm/15cm ne te dy drejtimet (Plegma)		m2		0.00	0.50	550.0	0.00		0.00	1.00	275.00
5	3.212/a	Shtrese stabilizant t=5cm		m2		0.05	0.06	550.0	27.50		1.72	2.00	31.63
		SHUMA 5:		Lek									
16		Punime te rehabilitimit kanalit vadites (bjefti l poshtem)											
1	3.25/a	Gërmim me krahe ne seksion te detyruar me gjeresib > 1m, h=1.5 m, toke e bute.		m3		4.90	0.00	450.0	2205.00	90.00	55.13	5.00	0.00
2	3.243/1	Struktura te holla monolite betoni C 16/20		m3		12.80	2.29	110.0	1408.00		35.20	5.00	251.90
3	3.212/a	Shtrese stabilizant t=5cm		m2		0.05	0.06	110.0	5.50		0.69	1.00	6.33
4	An-5	Zhblokim i kanalit fundor (shka kuesi) me sonde me presion ujdhe zevendesimi l pjeseshem l tubacionit Ø 600mm		ml		0.00	2.00	55.0	0.00		0.00	1.00	110.00
5	An-6	FV tub metalik Ø 300mm per kalimet ne muge kanali vadites		ml		0.00	0.00	6.0	0.00		0.00	1.00	0.00
6	2.182	Konstruksione metalike te thjeshta (shka llet e kules se kontrollit)		ton		36.00	10.10	0.4	14.40		1.80	1.00	4.04
7	An-7	F.vreze e poxide per inkastimin e ankoreve te shka lleve ne kullen e kontrollit		kg		0.00	0.00	4.0	0.00		0.00	1.00	0.00
8	4.12/15	F.V saracineska celiku me flanaxha , Pn25 bar, 4600		cope		33.30	8.90	1.0	33.30		4.16	1.00	8.90
9	An-8	Fumizim - vendosje porta metalike		cope		0.00	0.00	2.0	0.00		0.00	1.00	0.00
10	An-9	Kontrollitubacionit fundor me kamera (perdermtime te tubit ne brendesiose bllokime nga interte)		ore		0.00	3.00	2.0	0.00		0.00	1.00	6.00
11	An-10	Rehabilitim i siperfaqes mjedore te demtuara dhe kthimi ne gjendjen e mepashme , muga, kanal, trup i diges		m2		0.00	0.00	3040.0	0.00		0.00	1.00	0.00
											Shuma	160.00	

Total i punonjesve te llogaritur sipas analizave te manualit eshte 160 punonjes , por eshte bere zbritja e numrit te punonjesve ne 100 pasi disa zera si psh betonimet mund te kryhen nga po te njejtet punonjes .

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licencë të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme), diplomë përkatëse, CV, librezë pune, si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.5, stafi inxhinierik si më poshtë:

- **Minimuni 2 (dy) Inxhinier Ndërtimi (Profili Strukture)**
- **Minimuni 2 (dy) Inxhinier Hidroteknik**

- **Minimumi 2 (dy)** Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder
- **Minimumi 1(një)** Inxhinier Mjedis
- **Minimumi 1(një)** Inxhinier Mekanik
- **Minimumi 1 (një)**Inxhinier Gjeoteknik
- **Minimumi 1 (një)**Inxhinier Gjeolog
- **Minimumi 1 (një)**Inxhinier Hidrogeolog
- **Minimumi 1(një)** Inxhinier Materialesh
- **Minimumi 1(një)** Inxhinier Projekt Menaxher (Ndertimi/Hidroteknik)

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

- b) Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.**
- c) 2 Inxhinieri i Ndërtimit (Profili Struktura)** janë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv, me qëllimin për realizimin me cilësi dhe kushte sipas standarteve.
- d) 2 Inxhinier Hidroteknik** është përgjegjës për të gjitha punimet me natyrë hidroteknike duke përfshirë kunetat/ rrjetin e kanalizimeve të ujërave të shiut referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- e) 2 Inxhinier Gjeodet/ Topograf/ Markshajder** janë përgjegjës për saktësinë e vëllimeve të gërmimit dhe sasitë e punimeve sipas matjeve topogjeodezike të parashikuara në projekt dhe kryerjen e azhurnimeve topografike, të cilat shtrihen në të gjithë objektin.
- f) 1 Inxhinier Mjedis,** do të jetë përgjegjës për të gjitha punimet që përfshijnë Inxhinierinë e Mjedisit. Ky kriter vjen si rezultat i punimeve në një qendër të banuar, me kohezgjatje punimesh relativisht të larta dhe Inxhinieri i Mjedisit do të ofrojë mundësinë e sigurimit të mbrojtjes së lartë të mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së ceshtjeve të mjedisit me pasoja sa më minimale të mundshme negative në mjedis.
- g) 1 Inxhinier Mekanik** do të jetë përgjegjës për pajisjet elektriko-mekanike ekzistuese në objekt sipas preventivit të punimeve siç janë portat e shkarkuesve tubacionet saracineskat etj .
- h) 1 Inxhinier Gjeoteknik** do të jetë përgjegjës për punimet e dherave sipas të zerave të

preventivit te punimeve pasi shumica e punimeve jane nentokesore dhe rreziku i cedimit dhe shkarjeve te skarpatave te diges eshte i larte eshte i nevojshem nje specialist qe njeh dhe siguron qendrueshmerine e tokes .

- i) **1 Inxhinier Gjeolog**, do te jete pergjegjes per studimet e paketes se shtresave te tokes per shkak te punimeve te germimit, aty ku kalon gjurma e projektit dhe ne zonen e ndikimit perreth.
 - j) **1 Inxhinier Hidrogjeolog** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinieri hidrogjeolog** pasi në preventiv janë parashikuar punime dherash ne prani ujerash mbi dhe nentokesore.
 - k) **1 Inxhinier Materialesh** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinieri materialesh** pasi në preventiv janë parashikuar punime per materiale te betonit qe do te jene ne prezence te vazhdueshme te ujerave siperfaqesore, gjithashtu do te behet perzgjedhja e materialit qe do te mbushe trupin e diges te jete sipas specifikimeve teknike . Rendesia e cilesise se materialeve qe do te perdoren ne kte objekt eshte e larte ndaj lind nevoja e nje specialisti per perzgjedhjen dhe vendosjen e tyre ne veper.
 - l) **1 Inxhinier Projekt Menaxher** (Ndertimi/Hidroteknik) eshte i nevojshme nje person i kualifikuar si projekt menaxher sepse ky projekt eshte i lidhur ngushte me ruajtjen dhe zhvillimin e zones . Duke pasur pervec aspektit teknik dhe nje impakt te madh social lind domosdoshmeria e nje personi qe te menaxhoje projektin ne anen tekniko/ekonomike dhe sociale ne zone.
- i. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës inxhinierik *(jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë)*, si më poshtë:
- Minimumi 1 **(një)** Inxhinier Ndertimi Profili Transport
- 1 (një) Inxhinier ndertimi Duke analizuar preventivin e punimeve, si dhe referuar objektit të prokurimit disponueshmëria nga ana e operatorëve ekonomik ofertues të një inxhinier ndërtimi, si dhe mendimi i tij i specializuar ndihmon në zbatimin e kontratës me sukses duke arritur qëllimin e autoritetit kontraktor që përpos punimeve që do të kryhen, të kryejë një rrugë me standarte dhe punime sipas kushteve teknike, në përputhje me cilësinë që kërkon autoriteti kontraktor.

Disponimi i stafit inxhinierik do të deklarohet në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe *në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit* duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar më lart.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- b) Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit te punimve, si më poshtë:

- Teknik i Ndërtimi -jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Teknik Topograf - jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Teknik Mekanik- jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Teknik Hidroteknik- jo më pak se **1 (një)** punonjës
- Hidraulik – jo më pak se **4(kater)** punonjës
- Saldator – jo më pak se **3 (tre)** punonjës *(ku minimalisht njeri prej tyre te jete i specilizuar per montim tubash)*
- Hekurthyes - jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Kaperntier - jo më pak se **5 (pese)** punonjës
- Betonues – jo më pak se **5 (pese)** punonjës
- Hidroizolues – jo më pak se **3 (kater)** punonjës
- Gurepunues– jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Punonjes ne lartesi– jo më pak se **3 (tre)** punonjës
- Murator/suvatues – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Kopshtar – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Punetor per konstruksione metalike – jo më pak se **2 (dy)** punonjës
- Punëtorë të thjeshtë– jo më pak se **40 (dyzet)** punonjës

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

Kontratat e punës individuale (të vlefshme).

- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Te gjithë punojësit e mësipërm duhet të figurojnë ne listepagesat të shoqërisë minimalisht per periudhen 3 mujore.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e mesiperm , emer/mbiemer, profili i punes, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numrin e amazes dhe titullin e kualifikimit per diplomën/certifikaten përkatëse si dhe emrin e institucionit qe ka leshuar dokumentin per specialistet e kualifikuar me siper.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim dhe/ose përjashtimin nga pjesemarrja në prokurimet publike.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas deklarata B.

Shënim: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do i kërkojë ofertuesit i kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të mëposhtëm:

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në paragrafin 3 të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr.

514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Numri është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Teknik Ndërtimi** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit duke siguruar kështu kontrollin e cilësisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik Topograf** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve topografike duke siguruar kështu kontrollin e sasisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik Mekanik** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike duke siguruar kështu kontrollin e sasisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Teknik Hidroteknik** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar ndjekjen e realizimit të punimeve hidroteknike duke siguruar kështu kontrollin e sasisë së punime në të gjitha fazat e zbatimit të projektit.
- **Hidraulik** referuar specifikimeve teknike bashkëlidhur projektit teknik për të siguruar punimet hidraulike, bashkimet e tubacioneve sipas zerave të punimeve të preventivit të objektit.
- **Saldator** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve referuar zërave të analizave të preventivit të objektit.
- **Hekurkthyes** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen e duhur të punimeve referuar zërave të analizave të punimeve të preventivit të objektit.
- **Karpentier** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar kryerjen me efikasitet të punimeve, referuar zërave të analizave të preventivit të objektit.
- **Betonues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të betonit sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Hidroizolues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të filtrimeve të diges sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Gurpunues** referuar specifikimeve teknike dhe preventivit bashkëlidhur projektit teknik të ndërtimit është i nevojshëm për të siguruar efikasitetin në punime e veshjeve me gure të anës së bjetit të sipërme të diges.
- **Punonjes në lartësi** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të montimit të saracineskës që është në një gropë me thellësi 20m sipas zerave të preventivit të punimeve.

- **Murato/Suvatues** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të veshjeve të kanalit sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Kopeshtar** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve të bimesise të bjefit të poshtem sipas zerave të preventivit të punimeve.
- **Punetor për konstruksione metalike** bazuar në zërat e punimeve sipas preventivit si dhe të volumeve që do të kryhen referuar punimeve konstruksioneve metalike të thjeshta perkatesisht në shkallet e kullës së kontrollit sipas zerave të preventivit të punimeve.

Kërkesat e mësipërme bazohen në piken 4 Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 39 pika 6/c të VKM nr. 285 dt. 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku kërkohet që OE të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar, si dhe bazuar në rregullore “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre” miratuar me urdhrin nr. 200 dt. 16. 05. 2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës.

- a) **1 (një) punonjës** i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Eksperti për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e përgjigjeve të shpejta dhe efektive ndaj situatave emergjente, duke ofruar kujdes fillestar, organizim të ndërhyrjes dhe menaxhim të situatave kritike. Hartimi i Planeve të Emergjencës:

Zhvillimi i planeve për reagim në rast të emergjencave si aksidente, fatkeqësi natyrore, zjarre ose situata mjekësore kritike.

Identifikimi i burimeve dhe pajisjeve të nevojshme për përgjigje efektive.

Krijimi i Protokolleve të Ndihmës së Parë:

Përcaktimi i hapave dhe procedurave të ndihmës së parë për situata të ndryshme emergjente. Sigurimi që protokollet përputhen me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Trajnimi i Personelit: Organizimi i trajnimeve për stafin dhe komunitetet lokale në teknikat e ndihmës së parë dhe menaxhimin e emergjencave. Vlerësimi i Situatës në Emergjencë Analiza e Rreziqeve: Vlerësimi i shpejtë i situatës për të identifikuar rreziqet dhe prioritetet e ndërhyrjes. Përcaktimi i burimeve të nevojshme dhe ndarja e detyrave për ekipin e emergjencës.

Vendimmarrja e Shpejtë: Vendosja e masave të menjëhershme për të stabilizuar situatën dhe për të shmangur përkeqësimin e saj. Ofrimi i Ndihmës së Parë

Trajtimi i Plagëve dhe Gjendjeve Akute:

Aplikimi i teknikave të ndihmës së parë si ndalimi i gjakderdhjes, imobilizimi i frakturave, dhe trajtimi i djegieve. Reanimimi Kardiopulmonar (CPR):

Kryerja e CPR dhe përdorimi i pajisjeve si defibrilatori në rast të ndalimit kardiak.
Mbështetja e Viktimave: Ndihma psikologjike për viktimat dhe komunikimi për të ulur stresin gjatë emergjencës.

- b) **1 (një) punonjës** që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënës zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

- c) **1 (një) punonjës** “Ekspert Zjarrfikës” në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit nga data e hapjes së procedurës.

Argumentimi: Prania e një eksperti zjarrfikës në kantier pune është thelbësore për të garantuar sigurinë, mbrojtjen e jetës dhe pronës, si dhe për të siguruar përputhshmërinë me rregulloret ligjore. Më poshtë paraqiten disa argumente që mbështesin këtë kriter:

1. Parandalimi i zjarreve

Identifikimi i rreziqeve të zjarrit: Eksperti zjarrfikës analizon kantierin për të identifikuar burimet e mundshme të zjarrit, si mjetet elektrike, materialet e ndezshme ose gabimet në instalime. Masat parandaluese: Ai vendos dhe zbaton masa për të parandaluar ndezjen, përhapjen dhe eskalimin e zjarreve, duke siguruar që mjedisi të jetë sa më i sigurt.

Reagimi i shpejtë në raste emergjente. Menaxhimi i incidenteve: Nëse ndodh një zjarr, eksperti zjarrfikës është i trajnuar për të ndërhyrë menjëherë, duke minimizuar dëmet dhe duke shpëtuar

jetët. Koordinimi i evakuimit: Ai krijon dhe zbaton plane të qarta evakuimi, duke udhëzuar punonjësit në mënyrë efektive gjatë një emergjence.

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i punonjësve. Trajnimi i stafit: Eksperti zhvillon trajnime të rregullta për punonjësit mbi përdorimin e pajisjeve kundër zjarrit (si shuarësit e zjarrit), protokollet e evakuimit dhe sjelljen e duhur në situata emergjente.

Ndërtimi i kulturës së sigurisë: Ai rrit ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse ndaj zjarreve. Mbikëqyrja e pajisjeve dhe sistemeve kundër zjarrit

Inspektimi i rregullt: Eksperti kontrollon pajisjet kundër zjarrit në kantier (shuarësit, hidrantët, sensorët e tymit etj.) për të siguruar funksionimin e tyre të duhur.

Instalimi dhe mirëmbajtja: Ai siguron që të gjitha pajisjet dhe sistemet të jenë instaluar sipas standardeve dhe të mirëmbahen rregullisht.

Përputhshmëria me legjislacionin dhe standardet

Respektimi i rregulloreve: Eksperti zjarrfikës siguron që kantieri të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore dhe standardet e sigurisë ndaj zjarrit.

Dokumentimi: Ai krijon raporte dhe mbikëqyr dosjet teknike që tregojnë përputhshmërinë e kantierit me normat e sigurisë.

d) Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, ku në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për drejtuesin teknik të deklaruar, duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Librezë pune (përkatëse)
- CV përkatëse
- Kontratë noteriale pune e vlefshme (përkatëse)
- Diplomë

- Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik në bashkim, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë vendosur vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin Teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast

rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin Teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Në Kreun IV të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 1 “Drejtuesi teknik i shoqërisë”, gërma b) parashikohet: “Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur. Percaktimi i kërkesës për Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt garanton autoritetin jo vetëm për angazhimin të kësaj kohe e kryerjes së punimeve të drejtuesit teknik të shoqërisë por dhe si orientim për një person kontakti dhe urë lidhëse mes mbikqyresit të punimeve dhe AK për problematiken që do të haset gjatë realizimit të punimeve.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, se ka pjesë të stafit të punësuar:

- Eskavatoriste – jo më pak se **8** (*tetë*) punonjës
- Buldozerist – jo më pak se **3** (*dy*) punonjës
- Automakinist – jo më pak se **4** (*kater*) punonjës
- Shofer – jo më pak se **6** (*gjashtë*) punonjës

, të cilët duhet të figurojnë në listëpagesa të shoqërisë të punësuar për periudhën e kërkuar në pikën 2.3.6 në rastin kur mjetet/ makineritë e deklaruar janë në pronësi të operatorit ekonomik ofertues, në të kundërt kur mjetet/ makineritë disponohen me qera, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për secilin të paraqiten:**

Per punojesit e mesiperm duhet te paraqiten:

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të perkojë me kërkesat e profilit të deklaruar për çdo punojes.

- Të figurojnë në listpagesat e E-Sig minimalisht për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, ku punojësit e mësipër duhet të figurojnë te regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.

- Gjate fazes së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata -“Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoriste, automakinist, buldozerist, duhet të deklarojnë: emer/mbiemer, profilin e punës, datën e kontratës së punës, numrin e deshmise së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmerisë së saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë eskavatorist / buldozerist , automakinistet, dhe shoferet nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E. ofertues.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet të paraqesë punojësit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

AK rezervon të drejtën e verifikimit të deklarimeve për punojësit e mesiperm, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kërkesat e mesiperme do të jetë kusht për skualifikimin e ofertes.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës., të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Manovratorët dhe shoferet janë të nevojshëm për shkak të makinerive të ndryshme që do të kryejnë punime germimi, ngjeshje materiali etj.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontate Furnizimi Për Materialet si me poshte:

2.1 Tombino me tuba betoni,Bordura betoni 15x25cm Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilesine

2.2 Hekur Autorizim Prodhuesi/Distributori te autorizuar te paraqitet kataloget perkates dhe ISO 9001/ekuivalente per cilesine

2.3.8 (Makineri, Pajisje)

- a) **Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë,** automjetet, makineritë dhe pajisjet (**sipas tabelës**) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës;

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes min 25 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10-12 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 12 – 18 ton	4 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 18-25 ton	3 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5 – 2 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 30 ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 50 ton.	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire mbi 40 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire mbi 35 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhire mbi 25 ton	5 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me krahe te gjate mbi 21 m	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me krahe te gjate mbi 18 m	1 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma MT	2 cope	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma MT	2 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me goma 3.5-5 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Minifadrome me goma MT	1 cope	Pronësi ose me qera
Minieskavator me zinxhir gome	2 cope	Pronësi ose me qera
Dumper mbi 20 ton MT	1 cope	Pronësi ose me qera
Dumper mbi 25 ton MT	1 cope	Pronësi ose me qera
Dumper mbi 30 ton MT	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul gome-hekur mbi 20 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul gome-hekur mbi 18 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul 1-3 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul me dhembe mbi 15 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Damper me goma MT deri ne 4 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Damper me goma MT deri ne 6 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Koke Terheqese	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 cope	Pronësi ose me qera
Grejder MT	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 cope	Pronësi ose me qera
Autopompë betoni	2 cope	Pronësi ose me qera
Fshese me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point)	1 cope	Pronësi ose me qera
Automjet i pajisur me kamera	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobot me sonde me presion per pastrim tubacionesh	1 cope	Pronësi ose me qera
Autovinc mbi 20 ton	1 cope	Pronësi ose me qera

Eskavator / Pirun Teleskopik MT	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat per bashkim tubash me elektrofuzion	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	3 cope	Pronësi ose me qera
Gjeneratora mbi 100 kva	2 cope	Pronësi ose me qera
Sonde mikrotunelesh per çpime horizontale me drejtim me lazer	1 cope	Pronësi ose me qera
Buldozier	3 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	2 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	3 cope	Pronësi ose me qera
Autobetoniere kantieri me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Betoniere kantieri	4 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator Betoni	4 cope	Pronësi ose me qera
Makineri per montim guardrail	1 cope	Pronësi ose me qera
Depozita uji minimumi 5000 litra	2 cope	Pronësi ose me qera
GPS	1 cope	Pronësi ose me qera
Dron i pajisur me lidar	1 cope	Pronësi ose me qera
Total Station	1 cope	Pronësi ose me qera
Kontenier (Zyrë Kantieri)	1 cope	Pronësi ose me qera

b) Gjithashtu në zbatim të VKM-së Nr.312, datë 05.05.2010, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë mjete dhe pajisje mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit, si më poshtë:

- Kokore – *jo më pak se 102 copë*
- Komplet i ndihmës së shpejtë – *jo më pak se 10 copë*
- Fikëse zjarri të lëvizshme – *jo më pak se 10 copë*
- Jelek – *jo më pak se 120 copë*
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt – *jo më pak se 50 copë*
- Prozhektor ndricimi – *jo më pak se 4 copë*
- Semafor rruge – *jo më pak se 4 copë*

□ **Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqiten:**

- 1- **Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike** duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe foto e dukshme të mjetit.
- 2- **Për mjetet e siguruar me qira**, të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të*

vlefshme), Taksat e paguara, Leje e transportit (*vetëm për kamionët dhe kamionçinat*) dhe Foto e dukshme të mjetit.

- 3- **Për paisjet/ makineritë në pronësi** të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).
- 4- **Për paisjet/ makineritë me qera** të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilin përcaktohet: Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në nenin 39 pika 6 d “Kërkesat të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6/d të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon... mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj njësia e prokurimit vendosi që të kërkojë që operatorët ekonomike të disponojnë mjetet dhe pajisjet e mësipërme sepse ato nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë bazuar sipas zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të hartuara nga specialistet e fushës. Çdo mjeti kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomikë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet

dhe pajisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Çdo mjet i përcaktuar në procedurën e prokurimit është kërkuar në funksion të kryerjes së zërave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varësi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të tyre. Përsa më sipër, numri i mjeteve është përcaktuar në bazë të nevojës pasi objekti zhvillohet në një kohë të shkurtër, pa cenuar grafikun e përcaktuar të punimeve dhe, veç të tjerash, Në lidhje me kriterin për disponimin e makinerive dhe pajisjeve, njësia e prokurimit vlerëson se referuar përmasave dhe volumit të punimeve objekt kontrate, operatorëve ekonomike u lind e nevojshme disponimi i makineri pajisjeve.

Shënim: Makineritë dhe pajisjet, janë kërkuar në bazë të specifikës së punës, volumit dhe punimeve paralele në katër fronte me shtrirje të gjerë gjeografike, kjo sipas gjurmëve dhe zbatimit të projektit të miratuar për punimet në terren.

- Kamion vetshkarkues me kapacitet 10-12 , 12-18 ,18-25 , mbi 25 ton . Jane mjete te domosdoshme ne transportin e materialit drejt pikes se depozitimit te inerteve duke u pershtatur dhe me ngarkesen , tonazhin e lejuar ne disa rruge , funksionalitetin etj
- Dumper 20-30 ton referuar analizave 3.158/4a, 3.112/b dhe An-1 jane te nevojshem sepse terreni eshte shume i veshtire , me prezenc baltrash dhe aluvionesh, jane me 6 akse dhe mundesojne levizjen ne keto terrene ndryshe nga kamjonat qe e kane te pamundur, gjithashtu sasia e madhe e materialit qe transportohet ne nje kohe te shkurter e ben te domosdoshem perdorimin e ktyre mjeteve.
- Rimorkiator për transportin e makinerive me kapacitet mbajtës min 30 , 50 ton , jane makineri te domosdoshme per transportin e makinerive te renda ne kantier .
- Eskavator me zinxhir min 25, 35 , 40 ton , referuar analizave 3.106/a , 3.124/2a, 3.87/a dhe An-1 jane mjete te domosdoshme sepse sasia e germimit eshte > 5000 m3 dhe koha eshte shume e shkurter .
- Eskavator me krahe te gjate min 18 , 21 m , referuar analizave 3.106/a , 3.124/2a, 3.87/a dhe An-1 dhe projektit eshte I domosdoshem nje mjet me krahe te gjate pasi bazuar ne projekt dhe ne terren ka zona ne biefin e siperm dhe ate te poshtem ku eshte e pamundur germimi me mjete te tjera gje qe e ben te domosdoshem nevojten e nje eskavatori me krahe te gjate .
- Eskavator me goma , fadrone me goma , minieskavator me goma 3.5-5ton, minifadrone , minieskavator me zinxhir gome - mjete te nevojshme per punimet ne rruge (kuroren e diges) pa demtuar shtresat asfaltike , gjithashtu mjete me tonazh te ulet qe mund te punojne ne shkarkuesin e diges pa demtuar betonin ekzistues dhe jane mjete qe mund te futen ne hapësira te ngushta sic jane dhembemizet e diges per shperndarje materiali referuar analizave 3.106/a , 3.124/2a, 3.87/a , An-1, 3.212/a.
- Kamionçine me kapacitet mbajtes deri ne 1.5-2 ton, e nevojshme per transporte te ndryshme jashte dhe Brenda kantierit dhe transporte te vogla puntoresh dhe materiale te vogla .
- Autopompe betoni, e nevojshme per veshje me betone te ekranit te diges dhe te kanalit
- Autobetoniere, e nevojshme per veshje me betone te ekranit te diges dhe te kanalit
- Betoniere Kantieri, e nevojshme per veshje me betone te ekranit te diges dhe te kanalit
- GPS , e nevojshme per matjet dhe planvendosjen e sakte te objektit

- Dron I pajisur me lidar , instrument topografik I nevojshem pasi siperfaqja e diges , pellgut ujembledhes dhe siperfaqes qe vadit eshte e madhe dhe me bimesi te dendur (gje qe ben te nevojshem perdorimin e lidarit)

-Ekskavator me zinxhire, referuar punime germimi

- Kamion veteshkarkues me kapacitet 3,5 – 5 ton, referuar analizes 3.158/4a e nevojshme per transporte te ndryshme jashte dhe Brenda kantierit dhe transporte te vogla puntoresh dhe materiale te vogla .

- Grejder, i nevojshem per perhapjen e njetratjeshem te shtresave pergjate gjithë segmentit

-Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point), sipas preventivit te punimeve

- Sonde mikrotunelesh per çpime horizontale me drejtim me lazer, sipas preventivit te punimeve Analiza Nr 5

-Autobot me sonde me presion per pastrim tubacionesh sipas preventivit te punimeve Analiza Nr 5

- Rrul me dhembe mbi 15 ton, i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike sipas analizes An-1

- Rrul ngjeshës mbi 18 ,20 ton,i nevojshem per ngjeshjen e shtresave ne kombinim me grejderin dhe mjete te tjera teknologjike,

- Rrul 1 -3 ton , mjet I nevojshem per ngjeshje te shresave ne hapësira te ngushta per punime civile te vogla .

- Vibrator betoni i jashtem, per betonimin e strukturave te armuara

- Buldozier , makineri e domosdoshme per spostimin e masivit te dheut ne biefin e poshtem

- Automjet I pajisur me kamera, sipas preventivit te punimeve Analiza Nr 9

- Pirun teleskopik MT, nevojitet per perdorim te shkarkimit te materialeve dhe transportin e tyre ne terren jo te favorshem si dhe sipas preventivit te punimeve perkatesisht analiza nr 4 .

-Autovinc mbi 20 ton , mjet I nevojshem per shkarkimin e ngarkesave te renda si tubacionet , zgarat metalike , paneleve , zbriten e mjeteve ne biefin e siperm dhe te poshtem etj duke ju referuar projektit distanca nga kurora e diges ne kuoten e aluvjoneve lind nevoja e autovincit mbi 20 ton pasi hapja e krahut te mjetit duhet te jete mbi 20 metra dhe kapaciteti mbajtes I larte gje qe e ben te domosdoshem . Autovinci sherben per zevendesimin e Vincit kulle I cili eshte I pamundur te vendoset pasi kurora e diges sherben si rruge lidhese per fshatrat .

- Pajisje per largim te ujrave nentokesore me sistemin gjilperthithese (Well Point) pajisje qe lidhet me largimin e ujrave nentokesore qe jane te pranishem ne trupin e diges .

Ndërsa mjetet dhe pajisjet të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si dhe të personelit, janë kërkuar në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë: 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”. Njësia e prokurimit vlerëson se pa këto mjete një operator ekonomik nuk mund të realizojë punët e parashikuara në këtë objekt prokurimi. Ruajtja dhe siguria në punë të jetëve njerëzore, është përparësi dhe detyrim ndaj punonjësve.

- 1.3.13 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë **1 (një) Impiantin e prodhimit** te betoni, (jo me shume se 50 km larg objektit) dhe duhet te paraqese Raport Vetemonitorimi planvendosjen dhe projektin teknologjik. Per fabriken e betonit duhet te paraqiten dokumentet e pronesise si akte çdoganimit ose fatura tatimore te blerjes, leja mjedisore e leshuar nga QKL kodi III.1.B + Akt-Miratimin. Ne rastin e fabrikes/linjes me qera/kontrate furnizimi dokumentete e mesiperme duhet te shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Ne kete rast operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin ligjor qe vereteton pronesine e tij (fature tatimore/zhdoganimit ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqeruar me foto)

Argumentimi: per distancën e transportit te betonit Distanca prej 50 km nga objekti argumentohet bazuar ne qendrueshmerine(viskozitetit) e materialit te betonit i cili duhet te ruaj parametrat teknik perpara hedhjes ne veper. Nese distanca e transportit te betonit do te jete me e madhe se 60 min deri ne veper, kjo do te krijonte demtim te materialit. Me planvendosje/genplan per te treguar me saktësisht qe largësia e kerkuar eshte e sakte.

- 1.3.14 Leje mjedisore e keshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për ”Grumbullimin dhe transportin e mbetjeve” më Kod III.2.B sipas kodeve 12 01 13 Mbetjet nga saldimet, 17 01 01 Beton, 20 02 02 Dhera dhe gure, 20 03 04 Llumra , 20 03 06 Mbetje nga pastrimi i ujerave te zeza.

- 1.3.15 Leje mjedisore e keshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit për ” Sherbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikim ne mjedis” më Kodi III.2.A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”. Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM Nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

- Kodi III.2.A (1+2) Shërbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikim në mjedis për të siguruar një implementim të veprës për të shmangur ose minimizuar në maksimum ndotjet mjedisore gjatë proceseve të ndryshme të punës në objekt.

1.3.16 Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë me një laborator testimi ku laboratori të ketë të akredituara këto teste SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M, SSH EN 1744- 1:2009+A1:2012, SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nënën të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nënën 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi ose autorizimit të distributorit të autorizuar për furnizimin e mallrave që do të ofrohen, është kërkesë ligjore e domosdoshme, me qëllim që OE të kenë autorizimin për tregtimin e produkteve nga prodhuesi apo distributori i autorizuar, apo marrëveshje bashkëpunimi, duke treguar origjinalitetin e tyre dhe ofruar garanci për mallrat që do të furnizohen.”

1.3.17 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar, preventivin (Bashkëlidhur DST) në dokumentat e tenderit. Në rast BOE, grafikun e punimeve duhet të jetë i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve përkatës.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nënës 4, pika 38/b dhe nënën 36, të LPP, si dhe nënën 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nënës 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit